

Aplikim për përfitime të sigurimit të papunësisë (UI)

Kush mund të marrë përfitime të sigurimit të papunësisë?

Nëse keni punuar në Nju-Jork ose në një shtet tjetër, mund të kualifikoheni për përfitime të sigurimit të papunësisë. Ju duhet:

- Të keni humbur punën **jo për fajin tuaj**;
- Të keni marrë **të ardhura të mjaftueshme** nga puna e mëparshme për të bërë një kërkesë;
- Të jeni **të gatshëm, të keni dëshirë dhe të jeni të aftë të filloni punë menjëherë**; dhe
- Të **kërkoni punë në mënyrë aktive dhe të dokumentoni** (në internet ose me shkrim) përpjekjet tuaja.

Edhe nëse nuk jeni i sigurt nëse kualifikoheni, gjithsesi duhet të aplikoni sa më shpejt që të jetë e mundur. Më pas, ne do të përcaktojmë nëse kualifikoheni apo jo. Për më shumë informacion rreth kualifikimit, ju lutemi shihni kapitullin 2 të manualit për aplikuesit në adresën www.labor.ny.gov/uihandbook.

Si të aplikoj për përfitime?

Mënyra më e shpejtë dhe më e sigurt për të aplikuar (paraqitur një kërkesë) për përfitime të sigurimit të papunësisë është përmes faqes sonë të internetit në adresën www.labor.ny.gov/signin.

Do t'ju duhet të përdorni një llogari në NY.gov. Udhëzimet për krijimin e një llogarie në NY.gov gjenden në faqen e identifikimit. Nëse hasni vështirësi me krijimin ose hyrjen në llogarinë në NY.gov, shihni udhëzimet e ilustruara në faqen e identifikimit, kontrolloni pyetjet më të shpeshta në NY.gov ose telefononi në numrin (800) 833-3000 nga e hëna në të premte, nga ora 08:30 deri në 16:30.

Kërkesën mund ta depozitoni **në internet**:

- Nga e hëna deri të enjten, nga ora 07:30 deri në 19:30;
- Të premten, nga ora 07:30 deri në 17:00; dhe
- Në fundjavë, nga ora 12:01 të shtunën deri në 19:00 të dielën.

Gjithashtu, kërkesën mund ta bëni edhe nëpërmjet numrit të telefonit pa pagesë (888) 209-8124, nga ora 08:00 deri në 17:00 nga e hëna në të premte. Shtypni numrin nëntë për **shërbimin e përkthimit**. Përdoruesit e **TTY/TDD**: kontaktoni një operator transmetimi në numrin (800) 662-1220 dhe kërkoni operatorit që të telefonojë numrin (888) 783-1370. Për përdoruesit e **shërbimit me video ose shërbimeve të tjera** kontaktoni operatorin e transmetimit dhe kërkoni që të telefonojë numrin (888) 783-1370.

Gjatë paraqitjes së kërkesës do t'ju duhet:

- Numri i **sigurimeve** shoqërore;
- Leja e drejtimit në **Shtetin e Nju-Jorkut ose numri i identifikimit të mjetit motorik** (nëse i keni të dyja);
- Adresa e **plotë postare** dhe kodi postar;
- Një **numër telefoni** ku mund t'ju kontaktojmë nga ora 08:00 deri në 17:00, nga e hëna në të premte;
- **Numri i regjistrimit si shtetas i huaj** (nëse nuk jeni shtetas amerikan dhe jeni i pajisur me kartë);
- Emrat dhe adresat e të gjithë punëdhënësve **tuaj** për 18 muajt e fundit, duke përfshirë edhe ata në shtete të tjera;
- **Numri i regjistrimit të punëdhënësit ose numri i identifikimit të punëdhënësit në shtetin federal (FEIN)** i punëdhënësit tuaj më të fundit (numri FEIN gjendet në formularët W-2);
- Kopjet e **formularëve SF8 dhe SF50**, nëse keni qenë punonjës në një shtet federal; dhe
- Formulari juaj më i fundit i lirim nga ushtria (**DD 214**), nëse keni qenë në ushtri.

Kërkesën mund ta paraqisni edhe pa i pasur të gjitha këto dokumente. Sidoqoftë, mungesa e informacionit mund ta vonojë pagesën tuaj të parë.

Nëse nuk mund t'i printoni faqet e internetit, mbani një stilolaps dhe letër pranë për të kopjuar informacionin.



Nëse do ta paraqisni kërkesën në internet dhe dëshironi që përfitimet të depozitohen drejtpërdrejt në llogarinë tuaj bankare, do t'ju nevojitet një çek me numrin routing të bankës dhe numrat e llogarisë rrjedhëse të shkruar në të.

Nëse ju nevojitet ndihmë për të paraqitur kërkesën

Nëse keni një aftësi të kufizuar ose probleme me gjuhën dhe ju nevojitet ndihmë për të paraqitur kërkesën, mund t'ju ndihmojë një mik ose i afërm. Sidoqoftë:

- Ju duhet të jeni me personin ndihmues sa herë që ky i fundit ju ndihmon dhe përdor PIN-in tuaj.
- Jeni ju përgjegjës për veprimet e personit ndihmues.
- Nëse nuk jeni i pranishëm gjatë kohës që personi tjetër ju ndihmon, mund t'i nënshtroheni penaliteteve, duke përfshirë humbjen e përfitimeve.

Kërkesa për përfitime javore/vërtetimi për përfitime

Pas paraqitjes së kërkesës duhet të bëni kërkesë për përfitime javore për çdo javë që jeni i papunë. Këtë mund ta bëni ose në internet në adresën www.labor.ny.gov/signin ose duke telefonuar linjën telefonike Tel-Service pa pagesë në numrin (888) 581-5812.

Kur paraqisni kërkesë për përfitime javore, do t'ju bëhen një sërë pyetjesh. Është e rëndësishme që të tregoni të vërtetën, duke qenë se ju i vërtetoni Departamentit të Punës se përgjigjet tuaja janë të vërteta dhe të sakta. Ndaj ky proces quhet edhe "vërtetimi për përfitime".

Për qëllimet e përfitimeve të sigurimit të papunësisë, një javë zgjat nga e hëna deri të dielën. Shumica e njerëzve i kërkojnë të dielën përfitimet javore për javën që lënë pas. Sidoqoftë, ju keni kohë deri të shtunën vijuese për ta bërë këtë.

Me ligj, java e parë e kërkesës suaj është **javë pritjeje**. Për këtë javë nuk do të merrni përfitime, por duhet të jeni të gatshëm, të keni dëshirë dhe të jeni të aftë për të punuar,

Kur do të filloj t'i marr përfitimet?

Që nga momenti kur paraqisni kërkesën tuaj duhen tre deri në gjashtë javë që të merrni pagesën e parë, pasi ne duhet të shqyrtojmë dhe përpunojmë aplikimin tuaj. Gjatë kësaj kohe nuk do të merrni përfitime. Nëse përcaktohet se kualifikoheni, do të merrni të gjitha përfitimet që ju takojnë.

Si do t'i marr përfitimet?

Nëse keni aplikuar në internet për sigurimin e papunësisë, ju është bërë pyetje nëse dëshironi t'i merrni përfitimet me depozitë direkte apo me kartë debiti. Nëse keni aplikuar nëpërmjet telefonit, përfitimet do t'i merrni me kartë debiti. Përfitimet nuk jepen më me çek.

Çështje të tjera të rëndësishme që duhet t'i dini

Pas aplikimit për përfitime, do të merrni një njoftim me postë, i cili mban emrin "**Përcaktimi i përfitimeve monetare**". Ju lutemi lexojeni menjëherë. Ai do t'ju tregojë nëse keni të ardhura të mjaftueshme për t'u kualifikuar apo jo për sigurim të papunësisë. Gjithashtu, ai do t'ju tregojë si të veproni nëse të gjitha të ardhurat tuaja nuk janë renditur në njoftim. **E rëndësishme: Përcaktimi i përfitimeve monetare nuk do të thotë se është vendosur përfundimisht që do të merrni përfitime.** Ai tregon thjesht nëse keni ose jo të ardhura të mjaftueshme për t'u kualifikuar. Nëse i përbushni të gjitha kërkesat, do të filloni të merrni përfitime. Nëse nuk kualifikoheni, do t'ju dërgojmë një letër.

Nëse nuk e mbani të përditësuar adresën **dhe numrin e telefonit, mund t'i humbisni përfitimet**. Posta në lidhje me sigurimin e papunësisë nuk përcillet nga zyra postare.

Dërgojni të gjithë pyetësorët menjëherë në mënyrë që përfitimet që ju takojnë të mos vonohen ose të mos mbahen.

Për më shumë informacion

Shihni **Sigurimi i papunësisë: Manuali për aplikuesit** në adresën www.labor.ny.gov/uihandbook për më shumë informacion rreth temave të diskutuara në këtë fletë informuese. Ky manual do t'ju dërgohet nëse pranoi ta merrni kur paraqisni kërkesën.

Pyetjet e shpeshta gjenden në faqen tonë të internetit në adresën <http://labor.ny.gov/ui/faq.shtm>.

Nëse keni **pyetje specifike** rreth kërkesës suaj ose statusit të saj, na dërgoni një **mesazh të sigurt** në adresën www.labor.ny.gov/signin. Identifikohuni në llogarinë tuaj në internet dhe klikoni në ikonën e zarfit në këndin e sipërm djathtas në faqen "Shërbimet e mia në internet". Ose kontaktoni me qendrën tonë telefonike të kërkesave në numrin (888) 209-8124. Të hënat dhe ditët pas një feste zyrtare janë ditët më të zëna me telefonata. Të enjtet dhe të premtet janë më pak të zëna.